



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:245925  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420860

AA.nr.702/2023

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për çështje administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Hajriz Hoti dhe Delushe Halimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F.Sh nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Ahmet Gjinovci avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2723/2022 të datës 08.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit F.Sh nga Prishtina.
- II. Anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2723/2022 i datës 08.08.2023.
- III. Anulohet vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë me numër të dosjes 336355 i datës 02.11.2022 dhe lënda i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur sipas padisë së paditësit F.Sh nga Prishtina, kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe

Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë të datës 02.11.2022, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, përmes avokat Ahmet Gjinovci nga Prishtina për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në ankesë në mes tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar të gjitha provat dhe si pasojë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike, tutje, se gjykata e shkallës së parë ka marr aktgjykimin e ankimuar pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike sepse nuk janë theksuar se cilat fakte i ka vërtetuar respektivisht vërtetuar me provat e administruara dhe cilave prova u fali besimin por është mjaftuar vetëm në një provë respektivisht përgjigjen në padi të palës së paditur, të cilën siç është theksuar pala paditëse nuk e ka poseduar. Me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të obligoj të paditurën që paditësit të ia njoh të drejtën në pension kontributdhënës ose të njëjtin ta prish dhe çështjen me shkresat e lëndës t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, vendimin e kontestuar të paditurës, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës me bazë juridike për anulimin e vendimit me numër të dosjes 336355 të datës 02.11.2022 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me të cilin është refuzuar ankesa e F.Sh nga Prishtina me nr. të ID-së... dhe numër të dosjes 336355 për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 22.11.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Kundër vendimit të shkallës së dytë, paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë, e që si rezultat e njëjta i është aprovuar me Aktgjykimin A.nr.1235/2021 të datës 19.09.2022, dhe çështja i është kthyer të paditurës në riprocedurë dhe rishqyrtim sipas vërejtjeve të gjykatës. Duke vepruar sipas aktgjykimit të gjykatës, e paditura ka nxjerrë aktvendim, me të cilin ka refuzuar përsëri ankesën e paditësit si të pabazuar, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për 15 vite stazh kontributiv. Në procedurën sipas ankesës, e paditura ka bërë shqyrtimin e shkresave të lëndës dhe me vendimin e datës 02.11.2022, të goditur me padi, e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar pasi që ka vërtetuar se paditësi bazuar në nenin 8 të Ligjit numër 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti nuk i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues, sepse nuk janë prezantuar dëshmi për 15 vite stazh kontributiv, gjegjësisht janë prezantuar prova materiale me të dhëna për 12 vjet, 3 muaj e 03 ditë. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata e shkallës së parë iu referuar Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti përkatësisht nenit 8 paragrafi 1 dhe Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues përkatësisht nenit 6, paragrafi 2. Gjykata e shkallës së parë pasi që administroi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vlerësimit të secilës provë veç e veç e të gjitha provave në lidhmëri me njëra tjetrën, ka gjetur se paditësi me dëshmitë e ofruara nuk e ka vërtetuar faktin se i njëjti e ka përvojën e punës mbi 15 vite stazh pensional kontributdhënës, para vitit 01.01.1999, e kërkuar sipas dispozitës së lartcekur. Nga kjo rezulton se paditësi nuk i ka 15 vite stazh pensional kontributdhënës para viti 01.01.1999, ashtu siç e ka vërtetuar e paditura me vendimin e goditur. Në kuptim të kësaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura me vendimin e datës 02.11.2022, me të drejtë paditësit ia ka refuzuar ankesën për njohjen e Pensionit Kontributdhënës të Moshës pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur kriteret e parapara ligjore për të qenë shfrytëzues i këtij lloj pensioni. Pretendimi i paditësit se i njëjti ka përvoje punë me shumë se 15 vite, dhe se ka prova të mjaftueshme me të cilën do ta vërtetoj, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar pasi që një pretendim i tillë nuk është provuar me asnjë dëshmi siç kërkohet me nenin 6 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3, pikat 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.7 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-

131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, në bazë të cilit edhe është refuzuar ankesa e paditësit, që t'i njihet e drejta në Pensionin kontributpagues.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), dhe nga neni 183 e 184 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo ligjore dhe jo i plotë në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë.

Aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë, sepse në të nuk janë shqyrtuar dhe administruar provat sipas pretendimeve të palëve në procedurë dhe sipas objektit të shqyrtimit – vlerësimit të ligjshmërisë së aktit përfundimtar të MPMS-DP-së, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, siç pretendon paditësi në ankesë.

Andaj, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund ta merr si të rregullt dhe të ligjshëm për arsye se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të lartcekura. Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që pas vendimit KO190/19 të datës 30.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, ka pasuar Ligji Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili e shfuqizon paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale, me arsyetimin “se pa të drejtë iu mohoi mijëra qytetarëve të drejtën e pensionit kontributpagues”. Sepse me ligjin e vjetër parashihej që të drejtën e përfitimit të pensionit kontributpagues ta kenë vetëm ata që dëshmojnë se kanë kontribuar për 15 vjet e më shumë në ish Fondin Pensionale të Kosovës. Ndërsa me ndryshimin e ligjit janë përfshi edhe qytetarët që janë larguar nga puna dhe nuk kanë arritur të mbushin 15 vjet përvojë pune. Andaj Gjykata e Apelit vendosi që ta anuloi aktgjykimin e ankimuar dhe njëherit ta anuloi edhe vendimin e MPMS-DP-së si jo të drejtë dhe jo ligjor.

Mbi këto arsye kolegji i Gjykatës së Apelit, e aprovoi ankesën si të bazuar meqë pretendimet e paditësit ishin pretendime të bazuara në ligj. Ngase duke marr parasysh dispozitat e lartcekura, kjo gjykatë e ka të pamundur të vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të paditurës, sepse nuk ju ka përmbajtur neni 48 të LPPA-së, për shkak se me arsyetimin e dhënë, nuk i ka dhënë

përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme në raport me ankesën e palës paditëse, nuk i ka përfshirë shpjegimet ligjore dhe faktike, dhe se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, ashtu që të njëjtin aktgjykim e anuloi dhe njëherit edhe vendimin e të paditurës MPMS-DP-së. Në vazhdim të procedurës organi i paditur pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës për vërtetimin e kritereve për njohjen e të drejtës në Pension kontribut pagues është i obliguar që të vendos ligjërisht lidhur me ankesën e paditësit, duke pasur parasysh Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenin 8/A me të cilin është paraparë Pensioni parcial kontributpagues i moshës.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 43 par.2 dhe 49 të LKA-së, dhe nenit 195 par. 1 pika e) i zbatueshëm përmes nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.702/2023, me datë 05.03.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi